



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE  
"KODRA BAILIFF SERVICE" SH.P.K.

LN-6925-10-2013

NIPT L32221069N

Adresa: Rr. "Frederik Shiroka", Kulla.3, Shk.3 Kati 2, Nr. 4, Tirane  
Web: [www.kodrabailiff.com](http://www.kodrabailiff.com)

Tel/Fax +355 (0) 42200056 Cel +355 (0) 699381888  
E-mail: [info@kodrabailiff.com](mailto:info@kodrabailiff.com)

Nr. 1460/9 0572-16 . Prot

Tiranë më 28.06.2016

URDHËR  
"PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

Adresa: Tiranë

Per dijeni: Debitorit : "LALA" sh.p.k.

Nipt J76418903B

Adresa: Krumë, Kukës

Kreditor : Shoqëria "3A&K" sh.p.k.

Nipt J90108008J

Adresa: Tiranë

Pranë Shoqërisë "Kodra Bailiff Service" sh.p.k. me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarimore me numër 0572-16 regj dhe me palë:

Kreditor : Shoqëria "3A&K" sh.p.k. Nipt J90108008J

Debitorit : "LALA" sh.p.k. Nipt J76418903B

Objekti : Fature tatimore shitje

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv "Faturë tatimore 1326 datë 26/07/2015 është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit "Vendimi Nr. 3318 Akti datë 30/05/2016 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë" dhe është vendosur "... Lëshimi i urdhrit të ekzekutimit per Faturë tatimore Nr. 1326 Akti datë 26/07/2015, me palë kreditore Shoqëria "3A&K" sh.p.k. dhe palë debitore "LALA" sh.p.k."

Me vendim të përmbaruesit gjyqësor privat, mbështetur dhe në nenin 519 të K. Pr. Civile është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, rrjedhimisht për ekzekutimin e tij, duhet të kryhet verifikimi dhe vendosja masës së sekuestros në QKR, mbi aktivin që zotëron pala debitore.

Për këtë arsye në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile.

URDHËROJ:

1. Vendosjes e masës së sekuestros konservative në kuotat e subjektit "LALA" sh.p.k. Nipt J76418903B, si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë.
2. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në të tjera aksione/kuota të cilat zotërohen nga pala debitore "LALA" sh.p.k. Nipt J76418903B në shoqëritë e tjera të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e vijues të K. Pr. Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
5. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor te vendit të ekzekutimit brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

"Kodra Bailiff Service" sh.p.k  
PËRMBARUESI GJYQËSOR  
Besmir KODRA



